



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28.1.2025

Nr: 43

Ora: 10:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË BASHKISË
CËRRIK, PËR PERIUdhËN 11 JANAR – 18 JANAR 2025**

Sot, më datë 28.1.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Bashkia Cërrik

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Bashkisë Cërrik për periudhën 11 janar deri më 18 janar 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

1. Gjatë periudhës 11-18 janar 2025, Bashkia Cërrik ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon.
 - “Tjetër”, “Kryetari i bashkisë Cërrik është i ftuar në një takim me diasporën në Selanik të Greqisë”, raportuar në datën 18.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 18.1.2025.

Data: 28.1.2025 Nr: 43
Ora: 10:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Cërrik për periudhën 11 janar – 18 janar 2025”

- “Tjetër”, “Kryetari është i ftuar në një takim me diasporën”, raportuar në datën 18.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 22.1.2025.

2. Nëpërmjet email-it të datës 22.1.2025, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Bashkisë Cërrrik informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, ose t’i paraqesë ato në seancën publike të datës 24.1.2025, ora 13:00.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin për Bashkinë Cërrrik ka dërguar pretendimet, duke sqaruar ndër të tjera se: *“Veprimtaria në fjalë nuk është organizuar nga Bashkia Cërrrik dhe nuk përbënte pjesë të aktiviteteve të saj zyrtare. Kryetari i Bashkisë ishte i ftuar në këtë takim, i cili kishte si qëllim diskutimin me diasporën mbi tema që nuk lidhen drejtpërdrejt me funksionet administrative të Bashkisë Cërrrik. Aktiviteti ishte i organizuar nga një grup tjetër organizativ, dhe ftesa për pjesëmarrje iu dërgua Kryetarit si përfaqësues publik dhe këtë aktivitet do ta publikonim në rrjetet sociale.*

Në momentin kur Kryetari u ftua të merrte pjesë në këtë aktivitet, informacioni për natyrën, kohën dhe vendin e organizimit të tij ishte i kufizuar. Ftesa për pjesëmarrje u mor shumë pranë datës së zhvillimit të veprimtarisë, duke mos lënë hapësirë të mjaftueshme për t’u përmbushur kërkesat dhe për t’u raportuar brenda afateve të përcaktuara.

3. Më datë 24.1.2025, ora 13:00, u zhvillua seanca dëgjimore, ku u ftuan palët në proces për t’u shprehur në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

E pranishme ishte përfaqësuesja e Bashkisë Cërrrik, zj. Mesida Xhelili, e cila u shpreh se: *“Pretendimet e ngritura nga KQZ për raportimet qëndrojnë, por për shkak të mungesës së informacionit menduam se veprimtaritë ku Kryetari i Bashkisë është i ftuar, mund ti publikonim edhe pa i raportuar. Gjithashtu pohoi se veprimtaria ishte një aktivitet elektorale.*

4. Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe pasi u dëgjuan pretendimet e palës në seancë vlerësohet se aktiviteti i mësipërm është aktivitet politik/elektorale dhe jo një “veprimtari publike” siç përkufizohet në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar.

Referuar pikës 3, të nenit 5, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet se:.... *“Raportimi bëhet për veprimtari të cilat organizohen ose bashkëorganizohen nga institucioni publik raportues. Nuk raportohen veprimtari ku institucioni publik, apo përfaqësues të tij janë ftuar për të marrë pjesë”.*

Vlerësohet se aktiviteti i mësipërm nuk është aktivitet institucional por politik dhe si i tillë nuk mbart detyrimin për raportim në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim.

Pas verifikimit të kryer, u vlerësua se postimet në llogarinë personale në rrjetin social “facebook” të z. Andis Salla, nuk mund të përbëjnë prova të mjaftueshme për të provuar lidhjen midis postimit dhe shkeljes administrative. Kryetari i bashkisë është organ me karakter dhe natyrë politike dhe si i tillë mund të postojë në faqen personale mesazhe politike, promovim të nismave politike, festimi i arritjeve politike apo cdo lloj platforme tjetër politike për tërheqjen e elektoratit.

Marrëdhëniet personale apo postimet në llogaritë personale në facebook të z. Andis Salla, dalin jashtë fushës së zbatimit dhe objekti të rregullimit të Kodit Zgjedhor dhe akteve normative në fuqi dhe si të tilla nuk mund të trajtohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Parashikimi i ndalimeve për sa i përket këtyre postimeve me natyrë politike interferon në liritë themelore siç janë liria për t’u shprehur si dhe liritë dhe të drejtat politike.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Bashkisë Cërrik.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI